# DËSHMI ARKIVI

**A-471990**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Katari: Netanyahu, pengesa më e madhe për përparimin e planit të paqes në Gazë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/katari-netanyahu-pengesa-me-e-madhe-per-perparimin-e-planit-te-paqes-ne-gaz-i588584` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 15:59:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 17:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1f9dad74dd2131208977319ad180d88d145bf35e59ba2ddece28c4e3be6ac8e3` |
| TEKSTI | `384026b98a5904dae0c79019ad3df5192f03a356a34feb16f4d7a3bd03b2385c` |
| PAMJA | `360534a203c7d0544c77049d7192c4c19853268b640e8148ca3f7a88601335fe` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `aed6d2efa3ca139fec913eec629bf6db73f0b012afff37e7ab39ded8a31f2d26` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/aed6d2efa3ca139fec913eec629bf6db73f0b012afff37e7ab39ded8a31f2d26`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Katari: Netanyahu, pengesa më e madhe për përparimin e planit të paqes në Gazë


TemA

26 Shtator 2026, 19:00Bota TEMA





Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Katarit, Sheiku Mohammed bin Abdulrahman Al-Thani, ka akuzuar drejtpërdrejt kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu dhe qeverinë e tij se janë bërë pengesa kryesore për zbatimin e planit të paqes për Gazën, i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara.

Në një intervistë për rrjetin televiziv CNN, kreu i diplomacisë deklaroi se qeveria izraelite po kryen shkelje të vazhdueshme që po dëmtojnë përpjekjet ndërmjetësuese.

“Kemi një listë të gjatë shkeljesh që, fatkeqësisht, qeveria e Netanyahut po kryen. Parimisht, kemi parë se ai është pengesa më e madhe aktualisht në përparimin e këtij plani paqjeje, ndërsa të gjithë ndërmjetësit po punojnë shumë për t’u siguruar që kjo marrëveshje të respektohet,” u shpreh Al-Thani.

Gjatë fjalës së tij, kryeministri i Katarit hodhi poshtë sërish raportimet e fundit se Doha ka financuar krahun ushtarak të Hamasit, duke ritheksuar se mbështetja e Katarit nuk ka shkuar kurrë për strukturat e armatosura.

I pyetur mbi rolin e Katarit si ndërmjetës mes Uashingtonit dhe Teheranit, Al-Thani bëri thirrje për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit dhe garantimin e lirisë së navigimit, duke dënuar çdo përpjekje për bllokadëDetare.

“Përdorimi i rrugëve detare për të bllokuar vendet dhe lirinë e navigimit është i papranueshëm. Kjo konsiderohet si përpjekje për presion dhe ne refuzojmë çdo bllokadë apo shantazh nga çdo shtet apo palë,” deklaroi ai.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Khamenei nuk është parë në publik prej muajsh: Presidenti iranian flet për gjendjen shëndetësore të liderit suprem]

17:50 Bota

Trump–Xi, armëpushim në luftën tregtare, SHBA dhe Kina zgjasin marrëveshjen, por përplasjet mbeten

16:10 Bota

[Mijëra protestues dalin në rrugët e Madridit në protestë, shkak kriza e emigrantëve në Ceuta]

15:50 Bota / 1 koment

[Senatorët republikanë dhe demokratë i drejtohen Trump: Mos e fto Putin në Miami]

13:10 Bota / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.